



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANILA Q. KAÇUPI
ADRESA NR.10, RESHIT COLLAKU,
AURORA, NR.1, NR.8
TEL: 676049924

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (AKSIONE)

Nr. repertori: 6808

Nr. koleksioni: 3884

Tirane më 23/12/2024

Anila
Kacupi

Firmosur elektronikisht nga
NISA me certifikaten :Anila
Kacupi
Data: 2024.12.23
10:38:50+01:00

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2024052940395424088



KONTRATË DHURIMI KUOTASH KAPITALI

Sot, më datë 23/12/2024, para meje Notere ANILA Q. KAÇUPI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, RESHIT COLLAKU, AURORA, NR.1, NR.8, u paraqit personalisht:

DHURUES: Ilir Kaso, atësia Sybi, amësia Memedi, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Marsel Kashen 2/42; Nd. 2; H. 1; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 7; Tiranë; 0000; Tiranë, lindur më 05/12/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033445945 dhe nr. personal H81205164N. (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Dhuruesi**")

PRANUES I DHURIMIT: Robert Kaso, atësia Sybi, amësia Merushe, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, me adresë Perlat Rexhepi Pall11 Ap 56; Nd. 11; Ap. 56; Njësia Administrative Nr. 5; Njesia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/05/1967, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038244484 dhe nr. personal G70506186H. (Këtu e në vijim, për efekt të kësaj kontrate referuar si "**Përfituesi i dhurimit**")

Rrethanat e hartimit të aktit noterial: Personat e lartpërmendur u paraqitën me vullnetin e tyre të lirë, të plotë e të pavesuar dhe deklaruan se kërkojnë hartimin e kësaj kontrate për dhurimin e kuotave të kapitalit. Unë noteri/ja, pasi verifikova identitetin e tyre dhe dokumentet e paraqitura, hartoj këtë kontratë, në bashkëpunim me palët, duke përcaktuar kushtet e mëposhtme:

Kushte paraprake:

Pala dhuruese **Ilir Kaso**, është pronar dhe ortak i shoqërisë "**RO-AL**" shpk me NUIS:J61811001M, me **3.70% pjesemarrje ne kuotat e kapitalit**.

Ortaku i shoqërisë **Ilir Kaso** ka vendosur të kryejë dhurimin e kuotave të kapitalit që zotëron në masën 3.70%, duke hequr dorë nga e drejta e pronësisë në mënyrë të plotë konform ligjit sipas kushteve që do të citohen me poshte për t'ia dhuruar keto të drejta duke përfshirë dhe detyrimet ortakut tjetër **Robert Kaso**.

Robert Kaso deklaron se pranon dhurimin e kuotave të kapitalit të ortakut të shoqërisë "**RO-AL**" sh.p.k në masën e plotë 100%, duke u shndërruar ne ortak i vetem me një kuota të vetme ne masen 100% duke marrë përsipër të gjithë të drejtat dhe detyrimt si ortak i vetem i shoqërisë me kushtet si do të caktohen me poshte.

Neni 1- Baza Ligjore

- 1.Neni 761 e vijues të Kodit Civil;
- 2.Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**", i ndryshuar;
- 3.Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "**Për Noterinë**".

Neni 2 - Objekti i kontrates

2.1.Objekti i kesaj kontrate është dhurimi i aksioneve të shoqërisë "**RO-AL**" sh.p.k, regjistruar ne QKB me NUIS: **J61811001M**, duke realizuar ndryshimin e pronësisë se kesaj shoqërie nga me ortak të vetem me 1 kuote ne masen 100% ne favor te z. **Robert Kaso**.

Neni 3- Kalimi i Pronesise nga Dhuruesi tek Pranuesi

Me anë të kësaj kontrate dhurimi kuotash, dhe menjehere me nenshkrimin e saj, Dhuruesi **Ilir Kaso** i dhuron Pranuesit të Dhurimit **Robert Kaso**, kuotën e tij prej 3.70% në kapitalin themeltar të Shoqërisë "**RO-AL**" sh.p.k, duke e shndërruar kapitalin e shoqërisë, ne 1 kuota me 1 ortak si më poshtë:

Robert Kaso ortak me 100% te kapitalit themeltar te shoqërisë; I cili deklaron se pranon dhurimin e kuotave nga Ilir Kaso, duke u shndërruar ne ortak i vetem i shoqërisë "RO-AL" shpk;

Neni 5- Heqje dore nga te drejtat



A2024052940395424088

Pala dhuruese deklaron nen pergjegjesine personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne ne cilesine e pronarit/ortakut ne lidhje me shoqerine "RO-AL" sh.p. k, menjehere pas nenshkrimit të kesaj kontrate.

Neni 6- Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Çdo lloj mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj kontrate, do te zgjidhet me mirekuptim ndermjet paleve, ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e ketyre mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 7- Te ndryshme

Për sa më sipër, **Robert Kaso**, pranon dhurimin e kuotave te kapitalit si me lart pershkruar me te gjitha te drejtat dhe detyrimet ligjore të cilat kanë lindur në momentin e nenshkrimit te kesaj kontrate dhe do te lindin ne vazhdim si pasoje e zoterimit te kuotes, perfshire detyrimet ndaj institucioneve shtetore (tatim mbi vleren e shtuar, tatim mbi te ardhurat, tatim ne burim, taksat dhe tarifat vendore, sigurimet shoqerore, sigurimet shendetesore, gjobat dhe kamatvonesat, faturime nga OSHEE dhe UKT etj.); ndaj punëmarrësve (pagat dhe cdo detyrim i cili rrjedh nga ligji dhe kontrata e punes); ndaj te treteve, shoqeri tregtare dhe person fizik (cdo e drejte\ detyrim i cili rrjedh nga kontrate qiraje, sherbimi, enfiteoze, leasing, kredi , huaje etj.) apo cdo e drejte\ detyrim ndaj shoqerive tregtare dhe\ ose organizate jo-qeveritare brenda dhe jashte territorit shqiptar ku Shoqeria "RO-AL" shpk eshte ortak\ anëtar, perfshire cdo te drejte\ detyrim i\ e cila nuk eshte permendur shprehimisht ne kete kontrate dhe ne menyre ligjore ose\ dhe kontraktuale i takon shoqerise "RO-AL" shpk. Pala dhuruese deklaron nen pergjegjesine personale, se heq dore nga te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i takojne ne cilesine e pronarit në lidhje me shoqerine qe transferon, pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

Palet bien dakord qe depozitimi i aplikimit perkates per regjistrimin e kalimit te pronësisë ne regjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit te Biznesit, do te kryhet Brenda 30 diteve nga nënshkrimi i kesaj kontrate.

Baza Ligjore

Neni 761 e vijues të Kodit Civil

Neni 73, pika 1, gërma "ç" (për kuotat e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose neni 117, pika 1, gërma "ç" (për aksionet e shoqërive aksionare/anonime) të Ligjit nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

Neni 62, gërma "ll", neni 63, pika 1, gërma "ç", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë"

Dispozitat Përfundimtare

Kontrata u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve kontraktuese nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

DHURUES: Ilin Kase





A2024052940395424088

PRANUES I DHURIMIT: Robert Kaso

Robert Kaso



NOTER

ANILA Q. KAÇUPI

Anila Kaçi

